



KOMUNIKATË

16.09.2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më 16.09.2009 ka mbajtur mbledhjen e vetë të 30-të të cilën e ka kryesuar kryetarja Nesrin Lushta. Në këtë mbledhje, është miratuar raporti nga mbledhja e 26-të e KQZ-së. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP-së ka publikuar raportin e të dhënave për procesin e certifikimit. Deri më 15 shtator, e që ishte edhe dita e fundit e afatit ligjor për aplikim të certifikimit, në KQZ kanë aplikuar pjesë në zgjedhje 76 subjekte politike. Prej tyre, 4 subjekte janë certifikuar në mbledhjen e parafundit të KQZ-së, kurse 72 subjekte kanë aplikuar më 14 dhe 15 shtator. Nga 72 subjekte, prej tyre 37 janë parti politike, 15 kandidatë janë të pavarur, 18 janë iniciativa qytetare dhe, 2 koalicione. Bazuar në aspektin e renditjes sipas përkatësisë, 34 subjekte janë nga komuniteti shqiptar, 21 janë nga komuniteti serb, 7 boshnjake, 2 subjekte janë malaziase, 3 turke, 1 rome, 2 ashkali, 1 egjiptiane dhe 1 subjekt nga komuniteti goran.

Në këtë mbledhje, KQZ ka shqyrtuar edhe raportin e Këshillit Operacional Zgjedhor, e ku është shqyrtuar projekti ECMI “Edukimi i votuesëve në komunat e reja”, i cili në parim edhe është miratuar. Gjithashtu, KQZ ka miratuar emërimet e anëtarëve të KQZ-ve në Rahovec, Graçanicë, Klllokot, Ranillug, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan.